

Forcimi i Qeverisjes Digjitale për Ofrimin e Shërbimeve në Kosovë

PLANI PER ANGAZHIM MJEDISOR DHE SOCIAL - PAMS

Draft

Tetor 2022

PLANI PER ANGAZHIM MJEDISOR DHE SOCIAL

1. Qeveria e Kosovës (QK) do të zbatojë Projektin për FORCIMIN E QEVERISJES DIGJITALE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE (P178162), me përfshirjen e Agjencisë të Shoqërisë së Informacionit (ASHI) në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB). SHOQATA NDËRKOMBËTARE E ZHVILLIMIT (IDA) ka rënë dakord të sigurojë financimin e Projektit.
2. QK-ja do të zbatojë masa dhe veprime konkrete në mënyrë që Projekti të zbatohet në përputhje me Standardet Mjedisore dhe Sociale (SMS). Ky Plan për Angazhimin Mjedisor dhe Social (PAMS) përcakton masat dhe veprimet materiale, çdo dokument apo plan specifik, si dhe kohën për secilin prej tyre.
3. QK-ja do të jetë gjithashtu në përputhje me dispozitat e çdo dokumenti tjetër Mjedisor dhe Social (M&S) të kërkuar sipas SMS-ve dhe të referuara në këtë PAMS, të tilla si; Plani i Përgjithshëm i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS), Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (PAPI), Proçedurat e Menaxhimit të Punës (PMP), ky PAMS, MOP dhe afatet kohore të specifikuara në këto dokumente M&S.
4. Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për përputhshmërinë me të gjitha kërkesat e PAMS-së edhe kur zbatimi i masave dhe veprimeve specifike kryhet nga ASHI-i e referuar në pikën 1 më sipër, ose ndonjë subjekt tjetër, siç janë kontraktorët dhe nën-kontraktorët.
5. Zbatimi i masave dhe veprimeve materiale të përcaktuara në këtë PAMS do të monitorohet dhe do të raportohet Bankës nga ana e QK-së, siç kërkohet nga PAMS dhe kushtet e marrëveshjes ligjore, dhe Banka do të monitorojë dhe vlerësojë progresin dhe përmbushjen e masave materiale dhe veprimeve gjatë zbatimit të Projektit.
6. Siç është rënë dakord nga Banka dhe Qeveria e Kosovës (QK), ky PAMS mund të rishikohet herë pas here gjatë zbatimit të projektit, për të pasqyruar menaxhimin përshtatës të ndryshimeve të projektit dhe rrethanave të paparashikuara ose si përgjigje ndaj performancës së projektit të kryer sipas kësaj PAMS-je. Në rrethana të tilla, ASHI në emër të Qeverisë së Kosovës do të dakordohet për ndryshimet me Bankën dhe do të përditësojë PAMS-në për të pasqyruar ndryshime të tilla. Marrëveshja për ndryshimet në PAMS do të dokumentohet përmes shkëmbimit të letrave të nënshkruara ndërmjet Bankës dhe ASHI-it në emër të Qeverisë së Kosovës. ASHI do të publikojë menjëherë PAMS-në e përditësuar.
7. Në rastet kur ndryshimet e projektit, rrethanat e paparashikuara ose performanca e projektit mund të rezultojë në ndryshime të rreziqeve dhe ndikimeve gjatë zbatimit të projektit, QK-ja do të sigurojë fonde shtesë, nëse është e nevojshme, për të zbatuar veprime dhe masa për adresimin e rreziqeve dhe ndikimeve të tilla, të cilat mund të përfshijnë rreziqe për mjedisin, rreziqe të punës, shëndetit dhe sigurisë.

MASAT DHE VEPRIMET MATERIALE		KORNIZA KOHORE	ENTITETI/AUTORITETI PËRGJEGJËS
MONITORIMI DHE RAPORTIMI			
A	<p>RAPORTIMI I RREGULLT:</p> <p>Përgatitni dhe dorëzoni në Bankën Botërore (BB) raporte të rregullta monitorimi mbi performancën mjedisore, sociale, shëndetin dhe sigurinë (MSSHS) të Projektit, duke përfshirë por pa u kufizuar në zbatimin e PAMS, statusin e përgatitjes dhe zbatimit të dokumenteve M&S të kërkuara sipas PAMS-së, aktivitetet e angazhimit të palëve të interesuara, funksionimit të mekanizmave të ankesave.</p>	Dorëzoni pranë Bankës raporte gjashtëmujor të progresit gjatë gjithë ciklit të projektit, duke filluar pas datës së hyrjes në fuqi.	<i>Agjensia Për Shoqërinë e Informacionit (ASHI) nëpërmjet NJësisë të Zbatimit të Projektit (NjZP-së)</i>
B	<p>INCIDENTET DHE AKSIDENTET:</p> <p>Njoftoni menjëherë Bankën për çdo incident ose aksident në lidhje me projektin, i cili ka ose ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në mjedis, komunitetet e prekura, publikun ose punëtorët, duke përfshirë, ndër të tjera, rastet e shfrytëzimi dhe abuzimi seksual (SHAS), ngacmimit seksual (NS) dhe aksidentet.</p> <p>Jepni detaje të mjaftueshme në lidhje me incidentin ose aksidentin, duke treguar masat e menjëhershme të ndërmarra ose që janë planifikuar të merren për ta trajtuar atë, dhe çdo informacion të dhënë nga çdo kontraktor dhe/ose firmë mbikëqyrëse, sipas rastit. Më pas, me kërkesë të Bankës, përgatitni një raport mbi incidentin ose aksidentin dhe propozoni çdo masë për ta trajtuar atë dhe për të parandaluar përsëritjen e tij.</p>	Njoftoni Bankën për çdo incident ose aksident jo më vonë se 48 orë pas vënies në dijeni për incidentin ose aksidentin, ndjekur nga raporte të detajuara për incidentin brenda afatit kohor të vendosur nga Banka pas njoftimit të parë.	<i>NjZP-ja ne ASHI</i>
	<p>RAPORTET MUJORE TË KONTRAKTORËVE:</p> <p>ASHI përmes NjZP-së do t'u kërkojë të gjithë kontraktorëve që të dorëzojnë raporte mujore monitoruese mbi PMMS të përgjithshëm, procedurën e menaxhimit të punës, shëndetin dhe sigurinë në punë dhe zbatimin e MZA-së. Këto raporte do të dorëzohen nga kontraktorët tek NjZP-ja në ASHI dhe nga NjZP/ASHI tek Banka Botërore.</p> <p>Furnizuesve dhe ofruesve të shërbimeve do t'u kërkojë të dorëzojnë raporte mujore të monitorimit për NjZP-në, të cilat adresojnë si aktivitetet teknike ashtu edhe ato të MSSHS-së.</p>	Raportet mujore të dorëzohen në BB brenda 5 ditëve nga marrja prej kontraktorëve	<i>ASHI përmes NjZP-së</i>
ESS 1: VLERËSIMI DHE MENAXHIMI I RREZIQEVE DHE NDIKIMEVE MJEDISORE DHE SOCIALE			
1.1	<p>STRUKTURA ORGANIZATIVE:</p> <p>Krijoni një strukturë organizative brenda Njësisë së Zbatimit të Projektit (NjZP) në ASHI me staf të kualifikuar për të mbështetur menaxhimin e rreziqeve MSSHS të Projektit). Kjo do të përfshijë si minimum; Një specialist mjedisi dhe një specialist social me kualifikime dhe përvojë të pranueshme për Bankën. Pjesë e NjZP-së do të jenë edhe specialistë të tjerë si Drejtori i Projektit, Koordinator i Projektit, specialist i prokurimit, specialist i menaxhimit financiar (MF), specialistët mjedisor dhe social, të monitorimit, vlerësimit dhe komunikimit.</p>	Specialisti mjedisor dhe social do të kontraktohet ose emërohet jo më vonë se 30 ditë pas datës së hyrjes në fuqi të projektit. Me pas, ky pozicion rruet gjatë gjithë ciklit të zbatimit të Projektit Një vlerësim deri në 5 javë të stafit (SW) për specialistët M&S është parashikuar për mbështetjen e zbatimit, financuar si pjesë e kostos së përgjithshme të menaxhimit të projektit	<i>NjZP-ASHI</i>

MASAT DHE VEPRIMET MATERIALE		KORNIZA KOHORE	ENTITETI/AUTORITETI PËRGJEGJËS
1.2	<p>VLERËSIMI MJEDISOR DHE SOCIAL</p> <p>Huamarrësi ka përgatitur PMMS-në e përgjithshme për të identifikuar, adresuar dhe zbutur rreziqet dhe efektet mjedisore dhe sociale të Projektit si rrjedhojë e punimeve civile në shkallë të vogël (dhomat për pajisjet), vendosjes dhe instalimit të pajisjeve në qendrën e rikuperimit nga fatkeqësitë në përputhje me Udhëzuesin Mjedisor, te Shendetit dhe Sigurise për Telekomunikimin te BB dhe për ndikimet që lidhen me akumulimin gjatë viteve të mbetjeve elektronike gjatë fazes te funksionimit. Ky PMMS i përgjithshëm do të konsultohet, miratohet, publikohet dhe zbatohet gjatë gjithë ciklit jetësor të zbatimit të projektit.</p>	PMMS-ja e përgjithshme të përgatitet, përfundohet, konsultohet, miratohet dhe publikohet gjatë vlerësimit dhe do të zbatohet më pas gjatë gjithë ciklit të zbatimit të projektit	<i>NjZP-ASHI</i>
1.3	<p>MJETET DHE INSTRUMENTET E MENAXHIMIT:</p> <p>Përditësoni, miratoni dhe zbatoni mjetet e mëposhtme të menaxhimit në përputhje me kërkesat e Standardeve Mjedisore dhe Sociale të aplikueshme, të tilla si: PMMS-ja e përgjithshme, PAPI, PMP, ky PAMS.</p> <p>Përgatitni, miratoni dhe zbatoni një Manual Operativ te Projektit (MOP) të përshtatshëm për identifikimin/proceset e kontrollit (screening) dhe menaxhimin e rreziqeve M&S, duke përfshirë marrëveshjet dhe përgjegjësitë zbatuese dhe MZA-në në mënyrë të tillë që të jetë e pranueshme për Bankën.</p>	PMMS-ja e përgjithshme, PMP, PAPI dhe PAMS do t'i dorëzohen BB-së për miratim përpara vlerësimit të projektit. Pasi të miratohen, instrumentet zbatohen gjatë gjithë ciklit të zbatimit të Projektit MOP-ja do të përgatitet përpara efektivitetit të Projektit. Të gjitha ndryshimet në MOP do të dakordohen me Bankën Botërore. MOP-ja do të zbatohet gjatë gjithë fazes të zbatimit të Projektit	<i>NjZP-ASHI</i> <i>ASHI</i>
1.4	<p>MENAXHIMI I KONTRAKTORËVE:</p> <p>Huamarrësi do të krijojë dhe zbatojë procedurat e menaxhimit për furnitorët, ofruesit e shërbimeve dhe kontraktorët e tyre.</p> <p>Huamarrësi nëpërmjet NjZP-së do të sigurojë që TeR-ët e konsulentëve dhe dokumentet e tenderit (thirrja për oferta/kontrata e çdo kontraktori dhe furnizuesi të pajisjeve të IT-së, si dhe konsulentët që do të mobilizohen për shërbime të ndryshme konsulence) të përfshijnë në specifikimet MSSHS (dhe kodin e sjelljes) të dokumenteve të prokurimit aspektet përkatëse të këtij PAMS-je, duke përfshirë edhe ato të dokumenteve përkatëse, si atë të Procedurave të Menaxhimit të Punës. Më pas, Huamarrësi nëpërmjet NjZP-së do të sigurojë që kontraktorët, furnitorët/ofruesit e shërbimeve të jenë në përputhje me specifikimet MSSHS të kontratave të tyre përkatëse. Huamarrësi nëpërmjet NjZP-së do të sigurojë gjithashtu që kontraktorët të përgatisin dhe zbatojnë PMMS-të specifike të zonës në përputhje me specifikimet që do të përgatiten, konsultohen, miratohen dhe publikohen.</p>	Para përgatitjes së Dokumenteve të Tenderit dhe kontratave përkatëse. Procedurat të mirëmbahen gjatë gjithë kohës të zbatimit të projektit	<i>NjZP-ja me mbështetjen e specialistit të prokurimit/ASHI</i>
1.5	MONITORIMI MJEDISOR DHE SOCIAL:		

MASAT DHE VEPRIMET MATERIALE		KORNIZA KOHORE	ENTITETI/AUTORITETI PËRGJEGJËS
	NjZP-ja në ASHI është përgjegjëse për të monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e PAMS-së dhe raportet e monitorimit do të dërgohen si pjesë e raporteve të progresit të zbatimit të projektit. Konsulenti Mjedisor dhe Social (M&S) i punësuar nga ASHI do të monitorojë zbatimin e PAMS-së	Çdo vit, cdo tremujor	<i>NjZP/ASHI me mbështetje të specialistëve M&S</i>
ESS 2: KUSHTET E PUNËS DHE PUNËSIMIT			
2.1	<p>PROÇEDURAT E MENAXHIMIT TË PUNËS:</p> <p>Finalizoni, përditësoni, miratoni dhe zbatoni Procedurat e Menaxhimit të Punës (PMP) duke përfshirë, ndër të tjera, masat profesionale, të shëndetit dhe sigurisë (SHSP) që janë zhvilluar për Projektin, në përputhje me kërkesat e zbatueshme të ESS2, legjislacionit kombëtar në fuqi dhe në një mënyrë të pranueshme për Bankën. Dispozitat përkatëse të procedurave të menaxhimit të punës duhet të përfshihen në dokumentet e tenderit.</p> <p>Parimet e këtyre procedurave do të zbatohen gjithashtu për çdo kontraktor, në përputhje me ESS2. Kontraktorët do të zhvillojnë dhe zbatojnë Kodet e Sjelljes të cilat do të përfshijnë dispozita në lidhje me parandalimin e SHAS/NS, do të ofrojnë trajnime të rregullta për punonjësit duke përfshirë, por pa u kufizuar në SHSP, parandalimin e SHAS/NS</p> <p>Projekti do të krijojë dhe mirëmbajë një MZA për punonjësit. Procedurat e përgjithshme të menaxhimit të punës së Projektit do të integrohen në Manualin Operativ të Projektit</p>	<p>Të finalizohet PMP-ja përpara datës së efektivitetit të projektit. Këto procedura do të zbatohen gjatë gjithë fazes të zbatimit të Projektit.</p> <p>Zhvillimi i Kodit të Sjelljes dhe krijimi i MZA-së për punonjësit përpara angazhimit të punëtorëve dhe kontraktorëve të projektit dhe të mirëmbahet gjatë gjithë fazes të zbatimit të Projektit.</p>	<p><i>NjZP-ASHI</i></p> <p><i>Kontraktorët</i></p>
2.2	<p>MEKANIZMI I ZGJIDHJES TË ANKESAVE PËR PUNONJESIT E PROJEKTIT:</p> <p>NjZP/ASHI do të zhvillojë, mirëmbajë dhe operojë një mekanizëm për zgjidhjen e ankesave, i disponueshëm për të gjithë punonjësit e Projektit, siç përcaktohet në Planin e Menaxhimit të Punës (PMP) dhe në PMMS-në e përgjithshme dhe në përputhje me ESS2. Ai do të sigurojë adresimin e të gjitha çështjeve që lidhen me Projektin, duke përfshirë kushtet e punësimit; mosdiskriminimin dhe mundësitë e barabarta; organizatat/sindikatat e punëtorëve; punën e fëmijëve; punën e detyruar; ngacmimin (seksual ose tjetër); shfrytëzimin dhe abuzimin seksual dhe ngacmimin seksual (SHAS/NS) dhe ankesa të tjera sipas rastit. NjZP/ASHI do të verifikojë gjithashtu që të gjithë konsulentët e tjerë të kontraktuar të kenë krijuar MA të punonjësve përpara angazhimit të tyre.</p>	<p>MZA-ja do të jetë funksional përpara rekrutimit të punëtorëve të projektit. Mekanizmi do të mirëmbahet gjatë gjithë fazes të zbatimit të Projektit</p>	<p><i>NjZP-ASHI</i></p> <p><i>Kontraktoret</i></p>
2.3	<p>MASAT E SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË (SHSP):</p> <p>Zhvilloni dhe zbatoni masat përkatëse të shëndetit dhe sigurisë në punë (duke përfshirë masat e gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave) në përputhje me ESS2 dhe siç specifikohet në PMMS-në e përgjithshme. Këto masa SHSP do të përfshihen gjithashtu në manualin operativ të projektit (MOP) përpara fillimit të punës për instalimin e infrastrukturës Digjitale dhe do të mirëmbahen gjatë gjithë fazes të zbatimit të Projektit.</p>	<p>Masat SHSP të specifikuara në PMMS dhe manualin operativ të Projektit përpara fillimit të punës për instalimin e infrastrukturës digjitale dhe të mirëmbajtura gjatë gjithë fazes të zbatimit të Projektit. Financuar si pjesë e</p>	<p><i>NjZP-ASHI</i></p>

MASAT DHE VEPRIMET MATERIALE		KORNIZA KOHORE	ENTITETI/AUTORITETI PËRGJEGJËS
		kostos së përgjithshme të menaxhimit të projektit.	
ESS 3: EFICIENCA E BURIMEVE DHE PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I NDOTJES			
3.1	<p>MENAXHIMI I MBETURINAVE DHE MATERIALEVE TË RREZIKSHME:</p> <p>Përfshini, miratoni, publikoni dhe zbatoni masa dhe veprime për menaxhimin e mbetjeve dhe materialeve të rrezikshme. Këto masa duhet të specifikohen në PMMS-ne e përgjithshme në përputhje me ESS3 dhe dispozitat rregullatore të ligjit të Kosovës për mbrojtjen e mjedisit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet grumbullimit, paketimit, transportit, asgjësimit/shkatërrimit dhe/ose riciklimit të mbetjeve elektronike (e-mbeturina) në përputhje me dispozitat rregullatore. PMMS e përgjithshme do të identifikojë rreziqet dhe ndikimet kryesore M&S që lidhen me instalimin e pajisjeve të IT-së dhe mbetjeve të lidhura me to, (ii) do të përcaktojë masat zbutëse dhe (iii) do të përcaktojë dispozitat për trajtimin, transportin dhe asgjësimin e mbetjeve elektronike që rezultojnë nga instalimi i pajisjeve. Mbetjet elektronike duhet të asgjësohen në përputhje me Praktikën e Mira Nderkombetare të Industrisë (GIIP) (p.sh. Direktiva e BE-së për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE)).</p>	<p>PMMS e përgjithshme ti dorëzohet Bankës për miratim përpara vlerësimit të projektit.</p> <p>Masat dhe veprimet do të mirëmbahen gjatë gjithë fazes të zbatimit të projektit.</p>	<i>NjZP-ASHI</i>
3.2	<p>PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I NDOTJES DHE EFIÇENCËS SË BURIMEVE:</p> <p>Efikasiteti i burimeve dhe masat për parandalimin dhe menaxhimin e ndotjes janë mbuluar nga PMMS i përgjithshëm, i përgatitur.</p> <p>Huamarrësi do të përgatisë gjithashtu MOP-in, i cili do të specifikojë procedurat dhe masat e menaxhimit të mbeturinave elektronike dhe masat për përdorimin efikas të burimeve</p>	<p>Para fillimit të punimeve përkatëse.</p> <p>Këto masa dhe veprime do të mbahen gjatë gjithë fazes të zbatimit të projektit.</p>	<i>NjZP/ASHI me mbështetjen e kontraktorëve të angazhuar për punimet</i>
ESS 4: SHËNDETI DHE SIGURIA E KOMUNITETIT:			
4.1	<p>SHËNDETI DHE SIGURIA E KOMUNITETIT:</p> <p>Projekti nuk do të zhvillojë apo financojë aktivitete që mbështesin punime të mëdha civile dhe që mund të shkaktojnë rreziqe të konsiderueshme për sigurinë e komunitetit. Aktivitetet e propozuara të rinovimit, instalimit të pajisjeve të TIK-ut do të bëhen brenda godinave ekzistuese. Projekti gjithashtu mund të rezultojë në një sasi të shtuar të mbetjeve elektronike që mund të përbëjnë rrezik për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit nëse nuk menaxhohen siç duhet, veçanërisht me kushte të pasigurta pune për popullatat e cënueshme (d.m.th. gratë dhe romët). Prandaj, Huamarrësi do të zhvillojë dhe zbatojë masa dhe veprime për të vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet dhe efektet e mundshme të projektit për komunitetet lokale. PMMS-ja do të ofrojë dispozita për shëndetin dhe sigurinë, menaxhimin e zhurmës dhe pluhurit, menaxhimin adekuat të mbeturinave/mbeturinave elektronike, rrethimin adekuat të vend depozitimeve si dhe</p>	<p>Masat dhe procedurat duhet të përfshihen në PMMS dhe të specifikohen në MOP, si dhe të zbatohen gjatë gjithë fazes të zbatimit të Projektit</p>	<i>NjZP-ASHI</i>

MASAT DHE VEPRIMET MATERIALE		KORNIZA KOHORE	ENTITETI/AUTORITETI PËRGJEGJËS
	ndalimin e punes te fëmijëve dhe punës së detyruar. Proçedurat dhe masat per menazhimin e mbetjeve elektronike do të përshkruhen gjithashtu në MOP.		
4.2	DHBGJ DHE RREZIQET E SHAS/NS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT: Huamarrësi do të zhvillojë dhe zbatojë masa dhe veprime për të vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet e DHBGJ dhe SHAS, mekanizmi i ankesës së projektit të jete i pajisur në mënyrë të përshatshme për të marrë, regjistruar dhe lehtësuar zgjidhjen e ankesave të SHAS/NS. Këto masa do të specifikohen në PMMS.	Para fillimit të punimeve. Këto masa dhe veprime do të mbahen gjatë gjithë fazes të zbatimit të projektit	<i>NjZP-ASHI</i>
4.3	SENSIBILIZIMI I KOMUNITETIT: Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për Projektin, rreziqet e përfshira, veçanërisht në grumbullimin, transportin dhe asgjësimin dhe riciklimin e mbetjeve elektronike përmes angazhimeve të palëve të interesuara, dëgjësive me publikun, emisioneve ne radio dhe takimeve me komunitetin në përputhje me ESS4 dhe ESS10.	Para dhe gjatë zbatimit të Projektit	<i>NjZP-ASHI</i>
ESS 5: BLERJA E TOKËS, KUFIZIMET NE PËRDORIMIN E TOKËS DHE ZHVENDOSJA E PAVULLNETSHME			
Ky standard nuk është i aplikueshëm për ndërhyrjet e sugjeruara të projektit. Projekti nuk parashikon asnjë blerje të tokës/kufizim në përdorimin e tokës/zhvendosje të pavullnetshme.			
ESS 6: RUAJTJA E BIODIVERSITETIT DHE MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE TE GJALLA NATYRORE			
Ky standard nuk është i aplikueshëm, pasi projekti nuk pritet të zhvillojë aktivitete që mund të shkaktojnë rreziqe dhe ndikime negative në biodiversitet, prandaj nuk ka nevojë të zbatohen masa dhe veprime për vlerësimin e rreziqeve dhe ndikimeve të tilla.			
ESS 7: POPUJT INDIGJENË/ KOMUNITETE TRADICIONALE LOKALE TË NENSHERBYERA HISTORIKISHT			
Nuk ka popuj indigjene të pranishëm që banojnë në Kosovë. Prandaj, ky standard nuk është i aplikueshëm.			
ESS 8: TRASHËGIMIA KULTURORE			
Ky standard nuk është aplikueshëm pasi ndërhyrja e projektit nuk do të ketë ndonjë ndikim në trashëgiminë kulturore. Projekti do të marrë të gjitha masat për të identifikuar burimet e trashëgimisë kulturore dhe për të zhvilluar planet e nevojshme zbutëse në rast se ato preken. Projekti do të sigurojë që ndërtesat e përcaktuara për rinovim nuk janë ndërtesa të trashëgimisë kulturore dhe nëse janë do të sigurojë që rinovimi nuk do të bëjë asnjë ndryshim në strukturën e ndërtesave.			
ESS 9: NDËRMJETËSUESIT FINANCIAR			
Ky standard nuk është aplikueshëm për këtë projekt.			
ESS 10: ANGAZHIMI ME PALET E INTERESIT DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT			
10.1	PËRGATITJA DHE ZBATIMI I PLANIT TË ANGAZHIMIT TË PALËVE TE INTERESIT: Përgatisni, publikoni, miratoni dhe zbatoni një Plan Angazhimi të Palëve të Interesit (PAPI) në përputhje me ESS10. PAPI do të identifikojë aktorët kryesorë dhe do të përfshijë masa specifike për të lejuar angazhimin e vazhdueshëm me një gamë të gjerë agjencish publike, ndermarrje të sektorit privat dhe me qytetarët dhe strategjinë e duhur të komunikimit gjatë zbatimit të projektit, si dhe paraqitjen e ankesave. PAPI do të jetë në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e Projektit dhe rreziqet dhe ndikimet e lidhura me to. PAPI do të përshkruajë format e ndryshme të angazhimit që duhet të ndërmerren me të gjithë aktorët e projektit ose përdoruesit e mundshëm të qeverisjes elektronike,	PAPI duhet të përgatitet, konsultohet, miratohet dhe publikohet përpara Vlerësimit dhe të zbatohet gjatë gjithë fazes te zbatimit të Projektit. PAPI do të përditësohet periodikisht, sipas nevojës, gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit	<i>NjZP-ASHI</i>

MASAT DHE VEPRIMET MATERIALE		KORNIZA KOHORE	ENTITETI/AUTORITETI PËRGJEGJËS
	duke përfshirë grupet vulnerabël (si të moshuarit, gratë, romët, personat me aftësi të kufizuara etj).		
10.2	<p>MEKANIZMI I ANKESAVE TË PROJEKTIT:</p> <p>Huamarrësi do të zhvillojë dhe zbatojë rregullimet për mekanizmin e zgjidhjes së ankesave siç përshkruhet në PAPI dhe në përputhje me ESS10. Mekanizmat e aksesueshem të ankesave do të vihen në dispozicion të publikut për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave në lidhje me projektin. Do të zhvillohet një plan komunikimi dhe kjo duhet të sigurojë që mekanizmi i ankesave të jetë i aksesueshëm për të gjithë.</p>	Para fillimit të aktiviteteve të projektit dhe gjatë gjithë fazes të zbatimit të projektit	<i>NJZP-ASHI</i>
MBËSHËTETJE E KAPACITETEVE (TRAJNIMI)			
CS1	<p>Trajnimet do të ofrohen për Stafin e Ministrive përkatëse, NjZP-në, ekipin e zbatimit të Projektit, Agjencitë Zbatuese dhe institutet si dhe palët e interesuara përkatëse mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Planifikimin dhe angazhimin e palëve të interesuara • Zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit (PAPI) dhe monitorimin dhe vlerësimin e tij, (ii) zhvillimin dhe zbatimin e Proçedurave të Menaxhimit të Punës; (iii) Zhvillimin dhe zbatimin e PAMS; (iv) zbatimin e PMMS • Familjarizimin me Kornizen Mjedisore dhe Sociale (KMS) të BB-së, • Aspektet specifike të zbatimit të përgjithshëm të PMMS; • Trajnimet dhe dialoget për mekanizmat e raportit të progresit; • Informacionin mbi kërkesat e Bankës Botërore për raportimin e incidenteve • Trajnime për përgatitjen e manualit operativ të projektit, planit vjetor të punës, planit të prokurimit dhe projeksioneve të disbursimit; • Trajnimi për DHBGJ dhe SHAS 	Trajnimi do të fillojë para fillimit të aktiviteteve të projektit dhe do të vazhdojë gjatë gjithë zbatimit të projektit, sipas nevojës	<i>Ekipi M&S i Bankës Botërore NjZP/Konsulentët individual Kontraktorët</i>
CS2	<p>Punëtorët e projektit:</p> <p>Punëtorët e projektit do të trajnohen për çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë, parandalimin e SHAS/NS, gatishmërinë dhe reagimin ndaj situatave emergjente, raportimin e aksidenteve në punë dhe çdo trajnim tjetër të nevojshëm.</p>	Pas rekrutimit	<i>NjZP-ja Kontraktorët</i>